

Numri i lëndës: 2024:052976

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05423289

C.nr.875/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditëses M.Z.nga fshati P., Komuna V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 373.83 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.Z.nga fshati P., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën shkurt-dhjetor 2021, t'ia paguajë shumën **157.41 €**, me kamatë ligjore 8 % nga dita e ushtrimit të padisë me datë14.02.2024 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses në emër të inflacionit, e kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, në shumën 55.57 €; janar-dhjetor 2019, në shumën 136.40 €; janar-dhjetor 2020, në shumën 10.10 € dhe muajin janar të V.t 2021, në shumën 14.31 €, në shumën e përgjithshme 216.38 €.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë 99 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditëses, me datë 14.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i inflacionit në pagë, vlera e kontestit 373.83 €.

Në padi, paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën "B.H.", në V. dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën janar-dhjetor 2018, e paditura t'ia paguajë shumën 55.57 €; për janar-dhjetor 2019, shumën 136.40 €; për janar-dhjetor 2020, shumën 10.10 € dhe për periudhën janar-dhjetor 2021, t'ia paguajë shumën 171.76 €, në shumën e përgjithshme 373.83 €. Të drejtën e saj e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë

(tutje KKAK) të V.t 14.04.2017 dhe 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditëses ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 421 € ndërsa, se shkalla e inflacionit për V.n 2021 është 3.4 %, fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës.

Duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, gjykata, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me

Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe KKAK të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023, të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023, të datës 05.10.2023, dispozitat e KKAK-së për V.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që kërkesa për pagesën e shumës së kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2018, janar-dhjetor 2019, janar-dhjetor 2020 dhe muajin janar të V.t 2021 është parashkruar, kjo sepse paditësja ka ushtruar padi me datë 14.02.2024 dhe kështu ka kaluar afatin tre vjeçar brenda së cilës ka pasur të drejtë të realizojë kërkesën e saj për periudhën e lartcekur përkatësisht, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke llogaritur 3 vite mbrapa nga data e ushtrimit të padisë (shkurt 2024-shkurt 2021), del se kërkesa e paditëses për kompensim nga muaji janar i V.t 2021 e mbrapa, deri në janar 2018 është e parashkruar.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk ka pasur inflacion të theksuar, sipas nenit 35, par. 10 të kontratës është përcaktuar se shkalla e inflacionit duhet të përcillet për çdo vit dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe anën tjetër, nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës është përcaktuar se kjo përqindje për V.n 2020 është prej 0.2 %, për V.n 2021 është prej 3.4 % dhe për V.n 2022 është prej 11.6 %.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditësit në shumën 78 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 99 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142, 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.875/2024, Datë 07.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.